

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI POPULLOR**

L I G J

**PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALAJZISË PËR ELIMINIMIN
E TATIMEVE TË DYFISHTA DHE MËNJANIMIN E EVAZIONIT
FISKAL LIDHUR ME TATIMET MBI TË ARDHURAT"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I :

Neni 1

Ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malajzisë për eliminimin e tatimeve të dyfishta dhe mënjanimin e evazionit fiskal lidhur me tatimet mbi të ardhurat".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 11.5.1994
Nr.i ligjit: 7822

KRYETARI I KRYESISË
Pjetër Arbnori



11.1.1987 641

MARREVESHJE NDERMJET QEVERISE SE REPUBLIKES SE SHQIPERISE
DHE QEVERISE SE MALAIZISE PER ELEMINIMIN E TATIMEVE TE
DYFISHTA DHE MENJANIMIN E EVAZIONIT FISKAL LIDHUR ME TATIMET
MBI TE ARDHURAT

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Malajzisë duke dëshiruar të perfundojnë një Marrëveshje për eliminimin e tatimeve të dyfishta dhe shmangien e evazionit fiskal lidhur me tatimet mbi të ardhurat, kanë rënë dakord për sa vijon :

Neni 1

Subjektet që mbulon Marrëveshja

Kjo Marrëveshje do të zbatohet ndaj personave që janë rezidentë të njerit ose të dy Shteteve Kontraktuese.

Neni 2

Tatimet që mbulon Marrëveshja

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet për tatimet mbi të ardhurat që zbatohen nga një Shtet Kontraktues, pavarësisht nga menyrat e vjeljes së tyre.

2. Tatimet ekzistuese ndaj të cilave do të zbatohet Marrëveshja, janë në vecanti :

a) Në Shqipëri, tatimet e vjelura sipas :

- (i) Ligjit për tatim fitimin;
- (ii) Ligjit për tatimin e biznesit të vogël;
- (iii) Ligjit për tatimin e të ardhurave personale;
- (në vijim do t'i referohemi si "Tatimet Shqiptare")

b) Në Malajzi

- (i) tatimi mbi te ardhurat;
(ii) tatimi mbi te ardhurat nga nafta;
(ne vijim do t'i referohemi si "Tatimet Malaiziane")

4. Marreveshja do te zbatohet gjithashtu per tatime te njellojte ose teper te ngjashme te cilat do te vendosen pas dates se nenshkimit te kesaj Marreveshje, si shtojce ose ne vend te tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente te Shteteve Kontraktuese do t'i bejne te ditur njeri tjetrit ndryshimet qe jane bere ne ligjet perkatese tatimore.

Neni 3

Percaktime te pergjithshme

1. Per qellimet e kesaj Marreveshje, perderisa perm-
bajtja te mos e kerkoje ndryshe :

a) termi "Shqiperia" nenkupton Republiken e Shqiperise, dhe kur perdoret ne sensin gjeografik nenkupton territorin e Republikes se Shqiperise perfshire cdo zone tej ujrave te saj territoriale, qe ne perputhje me te drejten nderkombetare dhe ligjet e Republikes se Shqiperise mund te ushtroje te drejta lidhur me tabanin detar, nentoken e tij dhe burimet e tyre natyrore;

b) termi "Malaizia" nenkupton territoret e Federates Malaiziane, ujrat territoriale te Malaizise, tabanin detar e nentoken e ujrave territoriale dhe perfshin cdo zone qe shtrihet tej limiteve te ujrave territoriale te Malaizise, dhe tabanin detar e nentoken e nje zone te tille, qe ka qene ose do te jete ne te ardhmen e saksionuar nga ligjet e Malaizise dhe ne perputhje me te drejten nderkombetare nje zone mbi te cilen Malaizia ka te drejte sovrane per qellim zbulimi dhe shfrytezimi te burimeve natyrore.

c) termat "nje Shtet Kontraktuese" dhe " Shteti tjetër

8

Kontraktuese" nenkuptojne Shqiperine ose Malajzine sic e kerkon permabjtja ;

d) termi "person" perfshin nje individ, nje kompani dhe cdo grup tjeter personash , qe trajtohet si person per qellime tatimore;

e) termi "kompani" nenkupton cdo koorporate ose cdo person ligjor qe trajtohet si i tille per qellime tatimore;

f) termat " sipermarrje e nje Shteti Kontraktues" dhe "sipermarrje e shtetit tjeter Kontraktues" nenkuptojne respektivisht nje sipermarrje te ushtruar nga nje rezident i nje Shteti Kontraktues dhe nje sipermarrje te ushtruar nga nje rezident i Shtetit tjeter Kontraktues;

g) termi "tatim" nenkupton tatimin Shqiptar ose tatimin Malaizian sic e kerkon permabjtja;

h) termi " nenshtetas" nenkupton :

(i) cdo individ qe zoteron kombesine ose nenshtetesine e nje Shteti Kontraktues;

(ii) cdo person juridik, bashkepjesemarrje apo shoqeri qe gezon statusin si e tille nga ligjet ne fuqi ne njerin Shtet Kontraktues;

i) termi "trafik nderkombetar" nenkupton cdo transport me anije apo mjet fluturues qe kryhet nga nje sipermarrje e nje Shteti Kontraktues, pervec kur anija apo mjeti fluturues vepron vetem brendaperbrenda Shtetit tjeter Kontraktues;

j) termi "Autoritet kompetent :

(i) ne Shqiperi, Ministrine e Financave ose perfaqesuesine e autorizuar prej tij ;

(ii) ne Malajzi, Ministrine e Financave ose perfaqesue-

sin e autorizuar prej tij.

2. Persa i perket zbatimit te kesaj Marreveshje nga nje Shtet Kontraktues, cdo term i pa percaktuar ketu, perderisa permbajtja te mos e kerkoje ndryshe, do te kete kuptimin qe i eshte dhene sipas legjislacionit te atij Shteti lidhur me tatimet e te cilit zbatohet Marreveshja.

Neni 4

Rezidenti

1. Per qellime te kesaj Marreveshje, termi "rezident i nje Shteti Kontraktues" nenkupton:

a) ne rastin e Malaizise, nje person qe eshte rezident ne Malaizi per qellimet e tatimeve malaizeze; dhe

b) ne rastin e Shqiperise, nje person qe eshte rezident ne Shqiperi per qellimet e tatimeve shqiptare.

2. Kur per shkak te dispozitave te paragrafit 1 nje individ eshte rezident i te dy Shteteve Kontraktues, atehere statusi i tij do te percaktohet si vijon :

a) ai do te konsiderohet rezident i Shtetit ne te cilin ai ka nje banese te perhershme ne dispozicion te tij. Neqoftese ai ka nje banese te perhershme ne dispozicion te tij ne te dy Shtetet, ai do te konsiderohet rezident i Shtetit ne te cilin interesat e tij personale dhe ekonomike jane te lidhura me ngushte (qendra e interesave jetike);

b) neqoftese Shteti ne te cilin ai ka qendren e interesave jetike nuk mund te percaktohet, ose neqoftese ai nuk ka nje banese te perhershme ne dispozicion te tij ne asnjerin Shtet, ai do te konsiderohet rezident i Shtetit ne te cilin ai qendron rregullisht;

c) neqoftese ai qendron rregullisht ne te dy Shtetet

ose ne asnjerin prej tyre, ai do te konsiderohet rezident i Shtetit ne te cilin ai eshte nenshtetas;

d) neqoftese ai eshte nenshtetas i te dy Shteteve ose i asnjemit prej tyre, autoritetet kompetente te Shteteve Kontraktuese do ta zgjidhin kete ceshtje me mirekuptim reciprok.

3. Kur per shkak te dispozitave te paragrafit 1, nje person juridik eshte rezident i te dy Shteteve Kontraktues, atehere ai do te konsiderohet rezident i Shtetit ne te cilin eshte vendosur qendra e tij e drejtimit efektiv.

Neni 5

Seli e perhershme

1. Per qellime te kesaj Marreveshje, termi "seli e perhershme" nenkupton nje vend fiks biznesi nepermjet te cilit ushtrohet teresisht ose pjeserisht aktiviteti i sipermarrrjes.

2. Termi "seli (perfaqesi) e perhershme" perfshin ne vecanti:

- a) nje vend drejtimi;
- b) nje dege;
- c) nje zyre;
- d) nje fabrike;
- e) nje punishte ;
- f) nje miniere, nje pus nafte ose gazi ose cdo vend tjeter per shfrytezimin e burimeve natyrore, perfshire lenden drusore dhe prodhime te tjera pyjore;
- g) nje ferme ose plantacion;
- h) nje shesh ndertimi, montimi, instalimi apo projekt kompleks qe zgjat per me shume se 9 muaj.

3. Termi "seli e perhershme" nuk do te perfshije :

- a) perdorimin e paisjeve apo objekteve vetem per qellime magazinimi, ekspozimi ose te shperndarjes se mallrave qe i

11

perkasin sipermarrjes;

b) mbajtjen e nje gjendje mallrash qe i perkasin sipermarrjes vetem per qellime magazinimi apo ekspozimi;

c) mbajtjen e nje gjendje mallrash qe i perkasin sipermarrjes vetem per qellime perpunimi nga nje sipermarrje tjeter;

d) mbajtja e nje vend fiks biznesi vetem me qellim per blerjen e mallrave ose per mbledhje informacioni per sipermarrjen;

e) mbajtja e nje vendi fiks biznesi vetem per qellim te ushtrimit per sipermarrje te cdo aktiviteti tjeter me karakter pregatitor ose ndihmes;

4. Nje sipermarrje e nje Shteti Kontraktues do te konsiderohet se ka nje seli te perhershme ne Shtetin tjeter Kontraktues nese ajo ushtron aktivitete mbikqyrjeje e kontrolli ne kete Shtet tjeter per me teper se 9 muaj lidhur me nje aktivitet ndertues, instalues apo projekt kompleks qe eshte ndermarre ne kete Shtet tjeter.

5. Kur nje person (i ndryshem nga nje ndermjetes ose agjent i pergjithshem, komisionet apo cdo ndermjetes ne status te pavarur ndaj te cilit zbatohet paragrafi 6) vepron ne nje shtet Kontraktues, ai do te konsiderohet nje seli e perhershme ne Shtetin e permendur ne fillim, neqoftese :

a) ai ka, dhe ushtron zakonisht ne Shtetin e permendur ne fillim nje autoritet te perfundoje kontrata ne emer te sipermarrjes, pervec kur aktivitetet e tij kufizohen ne blerjen e mallrave per sipermarrjen;

b) ai mban ne Shtetin e permendur ne fillin nje gjendje mallrash qe i perkasin sipermarrjes nga te cilat ai rregullisht ploteson porosi ne emer te sipermarrjes; ose

c) ai manifakturon ose perpunon per sipermarrjen ne

Shtetin e permendur ne fillim, mallra qe i perkasin sipermarrjes.

6. Nje sipermarrje e nje Shteti Kontraktues nuk do te konsiderohet se ka nje seli te perhershme ne Shtetin tjeter Kontraktues vetem per faktin se ajo ushtron biznesin ne kete Shtet tjeter nepermjet nje ndermjetesi, komisioneri te pavarur, me kusht qe te tille persona veprojne brenda kuadrit te zakonshem ter aktivitetit te tyre. Megjithate, kur aktivitetet e nje agjenti te tille kryhen teresisht ne emer te asaj sipermarrjeje, ai nuk do te konsiderohet nje agjent me status te pavarur nese transaksionet midis agjentit dhe sipermarrjes jane kryer ne kondita qe ndryshojne nga ato qe do te ishin vendosur midis sipermarrjeve te pavarura.

7. Fakti qe nje kompani qe eshte rezidente e nje Shteti Kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga nje kompani qe eshte rezidente e Shtetit tjeter Kontraktues, ose qe ushtron aktivitet ne ate Shtet tjeter (nepermjet nje selie te perhershme ose ne forma te tjera) nuk perben ne vetvete arsye te mjaftueshme per te konsideruar njeren kompani seli te perhershme te tjeres.

Neni 6

Te ardhurat nga pasuria e patundeshme

1. Te ardhurat e realizuara nga nje rezident i nje Shteti Kontraktues nga pasuri te patundeshme te vendosura ne Shtetin tjeter Kontraktues mund te tatonen ne kete Shtet tjeter.

2. Per qellimet e kesaj Marreveshjeje, termi "pasuri e patundeshme" do te kete kuptimin qe ka sipas ligjit te Shtetit Kontraktues ku eshte vendosur prona ne fjale. Ne cdo rast ky term do te perfshije pasurite aseksores te pasurise se patundeshme, inventarin e gjalle dhe pajisjet e perdorura ne bujqesi e ne pyje, te drejtat ndaj te cilave zbatohen dispozitat e te drejtes private lidhur me pronen mbi token, uzufukti i pasurive te patundeshme dhe te drejtat ndaj pagesave fikse ose variabel per shfrytezimin ose te drejten per te shfrytezuar vendburime minerare, puse nafte ose gazi dhe burime e pasuri te tjera natyrore,

13

perfshire lenden drusore dhe prodhimet e tjera pyjore. Anijet, varkat dhe mjetet e transportit ajror nuk konsiderohen pasuri e patundeshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do te zbatohen ndaj te ardhurave te realizuara nga perdorimi direkt, dhenia me qira, ose perdorimi ne cdo forme tjeter i pasurive te patundshme.

4. Dispozitat e paragrafeve 1 dhe 3 do te zbatohen gjithashtu ndaj te ardhurave nga pasuria e patundshme te nje siper marrje dhe ndaj te ardhurave nga pasuria e patundshme e perdorur per kryerjen e sherbimeve personale te pavarura.

Neni 7

Fitimet nga aktiviteti i siper marrjeve

1. Fitimet e nje siper marrje te nje Shteti Kontraktues do te taten vetem ne ate Shtet pervec kur siper marrja ushtron aktivitet ne Shtetin tjeter Kontraktues nepermjet nje selie te perhershme te vendosur aty. Neqoftese siper marrja ushtron aktivitetin ne kete menyre (pra nepermjet nje selie te perhershme ne Shtetin tjeter), fitimet e siper marrjes mund te taten ne shtetin tjeter por vetem ajo pjese e tyre qe i atribuohet kesaj selie te perhershme.

2. Duke patur parasysh dispozitat e paragrafit 3, kur nje siper marrje e nje Shteti Kontraktues ushtron aktivitet ne Shtetin tjeter Kontraktues nepermjet nje selie te perhershme te vendosur aty, atehere ne secilin Shtet Kontraktues selise se perhershme do t'i atribuohen fitimet qe ajo do te realizonte sikur ajo te ishte nje siper marrje e vecante dhe e pavarur qe do te vepronte ne te njejtin aktivitet ose ne aktivitete te ngjashme, nen kondita te njejta ose te ngjashme, teresisht e pavarur nga siper marrja seli e perhershme e se ciles ajo eshte.

3. Ne percaktimin e fitimeve te nje selie te perhershme lejohet zbritja e shpenzimeve qe jane kryer per qellimet e selise se perhershme, perfshire shpenzimet e pergjithshme administrative

14

te drejtimit te cilat do te ishin te reduktueshme nese perderisa ato ne menyre te arsyeshme i dedikohen selise se perhershme, pavaresisht nese jane kryer ne Shtetin ku ndodhet selia e perhershme apo edhe gjetke.

4. Nese informacioni qe i paraqitet autoritetit kompetent eshte i pamjaftueshem per percaktimin e fitimeve qe i atribuohen selise se perhershme te nje siper marrje, dispozitat e ketij neni nuk do te pengojne aplikimin e ligjeve te atij Shteti lidhur me percaktimin e detyrimeve tatimore te nje personi, me kusht qe rezultati te jete ne perputhje me parimet qe permban ky Nen.

5. Asnje fitim nuk mund t'i atribuohet nje selie te perhershme vetem per faktin se ajo blen mallra per siper marrje.

6. Ne funksion te paragrafeve te meparshem, fitimet qe i atribuohen nje selie te perhershme do te percaktohet me te njejten metode cdo vit perderisa te mos ekzistojne arsyete te forta dhe te mjaftueshme per te proceduar ndryshe.

7. Kur fitimet permbajne elemente te te ardhurave qe trajtohen vecas ne nene te tjera te kesaj Marreveshje, atehere do te zbatohen dispozitat e atyre Neneve dhe nuk do te ndikohen nga dispozitat e ketij neni.

Neni 8

Transporti detar dhe ajror

1. Fitimet e realizuara nga nje siper marrje e nje Shteti Kontraktues nga veprimtaria e anijeve ose e mjeteve te transportit ajror ne trafikun nderkombetar do te tatohen vetem ne ate Shtet.

2. Paragrafi 1 do te zbatohet gjithashtu ndaj fitimeve nga veprimtaria e anijeve apo avjoneve te realizuara nga nje rezident i nje Shteti Kontraktues nepermjet pjesemarrjes ne nje ortakeri, nje biznes te perbashket apo ne nje agjensi nderkombe-

tare transporti.

Neni 9

Sipermarrje te bashkuara

1. Kur :

a) nje sipermarrje e nje Shteti Kontraktues merr pjese direkt ose indirekt ne drejtimin, kontrollin ose kapitalin e nje sipermarrje te Shtetit tjeter Kontraktues, ose

b) te njejtet persona marrin pjese direkt ose indirekt ne drejtimin, kontrollin apo kapitalin e nje sipermarrje te nje Shteti Kontraktues dhe te nje sipermarrje te Shtetit tjeter Kontraktues,

dhe ne secilin rast kushtet qe jane pranuar ose qe jane diktuar midis dy sipermarrjeve ne marredheniet e tyre tregtare apo financiare ndryshojne nga ato qe do te vendoseshin midis sipermarrjeve te pavarura, atehere cdo fitim qe do te realizohej nga njera sipermarrje por qe per shkak te konditave te vecanta te permendura ne fillim nuk eshte realizuar mund te perfshihet ne fitimet e asaj sipermarrjeve dhe te tatohet normalisht.

Neni 10

Dividentet

1. Dividentet e paguar nga nje kompani qe eshte rezidente e nje Shteti Kontraktues nje rezidenti te Shtetit tjeter Kontraktues mund te tatohen ne kete Shtet tjeter.

2. Megjithate, te tille dividente mund te tatohen gjithashtu ne Shtetin Kontraktues rezidente e te cilit eshte kompania paguese e dividenteve, ne perputhje me ligjet e ketij Shteti, por neqoftese marresi eshte pronari perfitues i dividenteve tatimi i ngarkuar nuk do te kaloje :

16

a) 5 perqind te shumes bruto te dividendeve nese pronari perfitues eshte nje kompani qe zoteron direkt te pakten 25 perqind te kapitalit te kompanise paguese te dividendeve;

b) 15 perqind te shumes bruto te dividendeve ne te gjitha rastet e tjera.

Autoritetet kompetente te Shteteve Kontraktuese me mirekuptim reciprok do te vendosin per menyren e aplikimit te ketyre kufizimeve.

Ky paragraf nuk do te kete efekt mbi tatimin e kompanive ldhur me fitimet nga te cilat jane paguar dividendet.

3. Ne funksion te ketij neni, termi "dividentet" nenkupton te ardhurat nga aksionet ose te drejta te tjera, qe nuk jane kerkesa borxhi, pjesemarrja ne fitime, si edhe te ardhurat nga te drejta te tjera korporative qe i nenshtrohen te njejtit trajtim tatimor si te ardhurat nga aksionet nga ligjet e Shtetit rezidente e te cilit eshte kompania qe ben shperndarjen e dividendeve.

4. Dispozitat e paragrafeve 1 dhe 2 nuk do te zbatohet nese pronari perfitues i dividendeve, duke qene rezident i nje Shteti Kontraktues, ushtron aktivitet ne Shtetin tjeter Kontraktues - nepermjet nje selie te perhershme te vendosur aty, dhe zoterimi lidhur me te cilin jane paguar dividendet eshte efektivisht i lidhur me kete perfaqesi te perhershme. Ne kete rast do te zbatohen dispozitat e nenit 7.

5. Kur nje kompani rezidente e nje Shteti Kontraktues realizon fitime ose te ardhura nga Shteti tjeter Kontraktues, ky Shtet tjete rruk zbaton tatim mbi dividendet e paguar nga kompania, pervec kur keto dividende i paguhen nje rezidenti te ketij Shteti tjeter ose kur zoterimi lidhur me te cilin jane paguar dividendet eshte efektivisht i lidhur me nje seli te perhershme, subjekt i tatimit nuk jane gjithashti as fitimet e pashperndara te kompanise, edhe sikur dividendet e paguar ose fitimet e pashperndara konsistojne teresisht ose pjeserisht si fitime apo te

ardhura te realizuara ne kete Shtet tjetër.

Neni 11

Interesat

1. Interesat qe krijohen ne nje Shtet Kontraktues dhe i paguhen nje rezidenti te Shtetit tjetër Kontraktues do te taten ne kete Shtet tjetër.

2. Megjithate, keto interesa mund te taten edhe ne Shtetin Kontraktues ku ato krijohen dhe ne perputhje me ligjet e ketij Shteti, por kur marresi eshte pronari perfitues i intereseve, tatimi i zbatuar nuk duhet te kaloje 10 perqind te shumes bruto te interesit.

3. Pamvaresisht nga dispozitat e paragrafit 2, interesat qe perfiton nje rezident i Shqiperise do te perjashtohen nga tatimi Malaizian nese huaja ose te tjera zoterime lidhur me te cilat paguhet interesi eshte nje hua e aprovuar sic percaktohet ne seksionin 2 (1) te Aktit te vitit 1967 te Malaizise mbi Tatinin mbi te Ardhurat.

4. Perjashtuar dispozitat e paragrafeve 2 dhe 3, Qeveria e nje Shteti Kontraktues do te perjashtohet nga tatimi ne Shtetin tjetër Kontraktues lidhur me interesat e realizuara nga Qeveria nga ky Shtet tjetër.

5. Per qellimet e paragrafit 4, termi "Qeveri":

(a) ne rastin e Malaizise nenkupton Qeverine e Malaizise dhe do te perfshije :

- (i) qeverite e shteteve;
- (ii) autoritetet lokale;
- (iii) institucionet staturore (shteterore, jo tregtare);
- (iv) Banken Qendrore te Malaizise (the Bank Negara Malaysia); and
- (v) institucione te tilla, kapitali i te cilave zoter-

onet teresisht nga Qeveria e Malaizise, nga Qeveria e Shtetece, autoritetet lokale ose institucionet statuore, nese do te bihet dakord kohe pas kohe nga autoritetet kompetente te Shteteve Kontraktuese;

(b) ne rastin e Shqiperise nenkupton Qeverine e Shqiperise dhe do te perfshije :

(i) Banken Qendrore te Shqiperise;

(ii) ato institucione, kapitali i te cilave zoterohet totalisht nga Qeveria e Shqiperise ose autoritetet lokale, nese do te bihet dakord kohe pas kohe midis autoriteteve kompetente te Shteteve Kontraktuese.

6. Termi "interesat" ne kuptimin e perdorur ne kete nenkupton te ardhurat nga kerkesat e borxhit te cdo lloji, te siguruara ose jo me hipotekim ndaj pasurive, qe gezojne ose jo te drejten e pjesemarrjes ne fitimet e huamarresit, dhe ne vecanti, te ardhurat nga obligacionet shteterore dhe lloje te tjera letrash me vlere.

7. Dispozitat e paragrafit 1, 2 dhe 3 nuk do te zbatohen neqoftese pronari perfitues i interesave, duke qene nje rezident i nje Shteti Kontraktues, ushtron biznes ne Shtetin tjeter Kontraktues ku krijohen interesat nepermjet nje selie te perhershme te vendosur aty dhe kerkesa e huase lidhur me kete seli te perhershme. Ne kete rast do te zbatohen dispozitat e nenit 7.

8. Interesat do te konsiderohen se krijohen ne nje Shtet Kontraktues kur paguesi eshte vete ai Shtet, nje nenndarje politike, nje autoritet lokal ose nje rezident i atij Shteti. Megjithate, kur personi qe paguan interesa, qofte ose jo rezident Kontraktues nje seli te perhershme ne lidhje me te cilen ka lindur huaja per te cilen paguhet interesi dhe keto interesa krijohen nga selia e perhershme, atehere interesat do te konsiderohen se jane krijuar ne Shtetin ku eshte vendosur selia e perhershme.

9. Kur per shkak te lidhjeve te vecanta midis paguesit

dhe pronarit perfitues te interesave ose midis te dyve dhe personave te trete, shuma e interesave te paguara, bazuar ne huane per te cilen paguhen, e kalon shumen mbi te cilen duhej te ishte rene dakord midis paguesit dhe pronarit perfitues ne mungese te lidhjeve te tilla te vecanta, dispozitat e ketij neni do te zbatohen vetem mbi shumen e permendur ne fund. Ne kete rast, pjesa qe kalon pagesen normale do te mbetet e tatueshme ne perputhje me ligjet e secilit Shtet Kontraktues, duke patur parasysh edhe dispozitat e tjetera te kesaj Marreveshje.

Neni 12

Te ardhurat nga e drejta e autorit

1. Te ardhurat nga e drejta e autorit qe krijohen ne nje Shtet Kontraktues dhe i paguhen nje rezidenti te Shtetit tjeter Kontraktues mund te taten ne kete Shtet tjeter.

2. Megjithate, keto te ardhura mund te taten gjithashtu ne Shtetin Kontraktues ku krijohen dhe ne perputhje me ligjet e ketij Shteti, por nese marresi eshte pronari perfitues i ketyre te ardhurave tatimi i ngarkuar nuk duhet te kaloje 10 per qind te shumes bruto te te ardhurave.

3. Termi " Te ardhura nga e drejta e autorit" nen dispozitat e ketij neni nenkupton pagesat e cdo lloji te marra per :

(a) perdorimin, ose te drejten e perdorimit, te cdo patente, marke tregtare, projekti ose modeli, plani, procesi ose formule sekrete, ose cdo te drejte autori per pune shkencore, ose per perdorimin ose te drejten e perdorimit te pajisjeve shkencore, tregtare apo industriale ose per informacione lidhur me eksperiencen shkencore, tregtare apo industriale;

(b) perdorimin, ose te drejten e perdorimit, te filmave kinematografike, ose kasetave per transmetimet ne radio ose televizion, cdo te drejte botimi te punimeve artistike ose shkencore.

4. Dispozitat e paragrafeve 1 dhe 2 nuk do te zbatohen nese pronari perfitues i ketyre te ardhurave, duke qene rezident i nje Shteti Kontraktues, ushtron biznes ne Shtetin tjetër Kontraktues ku krijohen keto te ardhura nepermjet nje selie te perhershme te vendosur aty, dhe e drejta ose prona lidhur me keto seli te perhershme. Ne keto rast do te zbatohen dispozitat e nenit 7.

5. Te ardhurat nga e drejta e autorit, do te konsiderohet se krijohen ne nje Shtet Kontraktues kur pagues eshte vete ai Shtet, nje nenndarje politike, nje autoritet lokal, nje institucion statutor ose nje rezident i atij shteti. Megjithate, kur personi qe paguan keto shperblime, qofte ose jo rezident i nje Shteti Kontraktues, ka ne njerin Shtet Kontraktues nje seli te perhershme me te cilen eshte lidhur dhe nga e cila ka lindur e drejta e pagimit te ketyre shperblimeve, atehere keto pagesa konsiderohen se kane lindur ne Shtetin ku eshte vendosur perfaqesia e perhershme.

6. Kur per shkak te marrredhenieve te vecanta te krijuara midis paguesit dhe pronarit perfitues ose midis te dyve dhe personave te trete, shuma e shperblimeve (te ardhurave) qe mbulon ky nen, duke patur parasysh perdorimin, te drejten apo informacionin per te cilin ato jane paguar, e kalon shumen per te cilen do te ishte rene dakord midis paguesit dhe pronarit perfitues ne mungese te marrredhenieve te tilla te vecanta, atehere dispozitatat e ketij neni do te zbatohen vetem mbi shumen e permendur ne fund. Ne nje rast te tille shuma e shperblimit qe kalon shperblimin normal, mbetet e tatueshme sipas ligjeve perkatese te secilit Shtet Kontraktues, duke patur parasysh edhe dispozitatat e tjera te kesaj Marreveshje.

Neni 13

Shperblimet teknike

1. Shperblimet teknike qe lindin ne nje Shtet Kontrak-

tues dhe i paguhen nje rezidenti te Shtetit tjeter Kontraktues mund te taten ne kete Shtet tjeter.

2. Megjithate, keto shperblime teknike mund te taten gjithashtu ne Shtetin Kontraktues ne te cilin ato krijohen dhe ne perputhje me ligjet e atij Shteti, por kur pronari perfitues i shperblimeve teknike eshte nje rezident i Shtetit tjeter Kontraktues tatimi i ngarkuar nuk duhet te kaloje 10 perqind te shumes bruto te shperblimeve teknike.

3. Termi "shperblime teknike" sipas perdorimit ne kete nen nenkupton pagesa te cdo lloji ndaj cdo personi, te ndryshme nga pagesat qe i behen te punesuarve nga personi qe ben pagesen, lidhur me cdo sherbim te nje natyre teknike, drejtimi apo konsultimi.

4. Dispozitat e paragrafeve (1) dhe (2) te ketij Neni nuk do te zbatohen nese pronari perfitues i shperblimeve teknike, duke qene nje rezident i nje Shteti Kontraktues, ushtron biznes ne Shtetin tjeter Kontraktues ne te cilin krijohen shperblimet teknike nepermjet nje selie te perhershme te vendosur aty, ose kryen ne ate Shtet tjeter sherbime personale te pavarura, dhe shperblimet teknike jane te lidhura efektivisht me kete seli te perhershme ose me keto sherbime. Ne kete rast do te zbatohen, sipas rastit, dispozitat e neneve 7 ose 15.

5. Shperblimet teknike do te konsiderohen se krijohen ne nje Shtet Kontraktues kur paguesi eshte vete ai Shtet, nje nenndarje politike, nje autoritet lokal, nje institucion statutor ose nje rezident i atij Shteti. Megjithate, kur personi qe paguan shperblimet teknike, qofte ose jo rezident i nje Shteti Kontraktues, ka ne nje Shtet Kontraktues nje seli te perhershme ne lidhje me te cilen eshte krijuar detyrimi per pagimin e shperblimeve teknike, dhe te tilla shperblime teknike kane lindur nga kjo seli e perhershme, atehere te tilla shperblime teknike do te konsiderohet se jane krijuar ne Shtetin Kontraktues ne te cilin eshte vendosur selia e perhershme.

6. Kur per shkak te lidhjeve te vecanta midis paguesit

dhe pronarit perfitues ose midis ketyre te dyve dhe personave te trete, shuma e shperblimeve teknike te paguara, per cfaredo lloj arsye, e kalon shumen e per te cilen do te ishte rene dakord mes paguesit dhe pronarit perfitues ne mungese te lidhjeve te tilla te vecanta; dispozitat e ketij neni do te zbatohen vetem ndaj shumes se permendur ne fund. Ne nje rast te tille, pjesa qe e kalon pagesen do te mbetet e tatueshme ne perputhje me ligjin e secilit Shtet Kontraktues, duke patur parasysh edhe dispozitat e tjera te kesaj Marreveshje.

Neni 14

Fitimet nga shitja e pasurise

1. Fitimet e realizuara nga tjetersimi i pasurive te patundeshme, qe i referohen paragrafit 2 te Nenit 6, mund te taten ne Shtetin Kontraktues, ne te cilin eshte vendosur kjo pasuri.

2. Fitimet nga tjetersimi i pasurive te tundshme qe bejne pjese ne pasurite aktiv te nje selie te perhershme qe nje sipermarrje e nje Shteti Kontraktues ka ne Shtetin tjetër Kontraktues ose i pasurive te tundeshme qe nje rezident i nje Shteti Kontraktues ka ne Shtetin tjetër Kontraktues per te kryer sherbime profesionale, perfshire edhe fitimet nga tjetersimi i vete selise se perhershme (vetem ose bashke me sipermarrjen), mund te taten ne kete Shtet tjetër. Sidoqofte, fitimet e realizuara nga tjetersimi i anijeve ose avioneve qe veprojne ne trafikun nderkombetar nga nje sipermarrje e nje Shteti Kontraktues dhe i pasurive te tundshme qe lidhen me veprimtarine e ketyre anijeve ose avioneve do te taten vetem ne Shtetin Kontraktues, rezidente e te cilit eshte sipermarrja.

3. Fitimet nga tjetersimi i cdo pasurie qe nuk mbulohet nga paragrafet 1 dhe 2 te ketij neni, do te taten vetem ne Shtetin Kontraktues rezident i te cilit eshte tjetersuesi.

Neni 15

Shperblimet personale te pavarura

1. Duke patur parasysh edhe Nenin 13, te ardhurat e realizuara nga nje rezident i nje Shteti Kontraktues lidhur me sherbimet profesionale ose aktivitete te tjera te nje karakteri ngjashem do te tatonen vetem ne ate Shtet. Megjithate, keto te ardhura mund te tatonen edhe ne Shtetin tjeter Kontraktues ne rrethanat qe vijojne :

(a) nese qendrimi i tij ne Shtetin tjeter Kontraktues zgjat per nje periudhe ose periudha qe ne total i kalon 183 dite ne vitin perkates kalendarik ; ose

(b) nese shperblimi per sherbimet e tij ne Shtetin tjeter paguhet nga rezidente te atij Shteti ose lind nga nje seli e perhershme qe nje person jo rezident i atij Shteti ka ne ate Shtet, dhe ne secilin rast ky shperblim i kalon 4000 dollare Amerikane ne vitin perkates kalendarik, pavaresisht nese qendrimi i tij ne ate Shtet eshte per nje periudhe ose periudha qe ne total jane me pak se 183 dite gjate atij viti.

2. Termi " sherbime profesionale" perfshin ne vecanti aktivitetet shkencore, letrare, artistike, arsimore si dhe aktivitetet e pavarura te mjekëve, dentisteve, avokateve, inxhinierëve, arkitekteve dhe llogaritareve.

Neni 16

Sherbimet personale te varura

1. Ne baze te dispozitave te neneve 17, 19, 20 dhe 21, pagat dhe shperblime te tjera te ngjashme qe perfitohen nga nje rezident i nje Shteti Kontraktues lidhur me punen e tij do te tatonen vetem ne kete Shtet, pervec kur puna eshte ushtruar ne Shtetin tjeter Kontraktues. Nese puna ushtrohet ne kete menyre, pra ne Shtetin tjeter Kontraktues, atehere keto te ardhura mund te tatonen ne kete Shtet tjeter.

2. Perjashtuar nga dispozitat e paragrafit 1 te ardhurat e realizuara nga nje rezident i nje Shteti Kontraktues lidhur me punen e ushtruar ne Shtetin tjeter Kontraktues do te tatonen vetem ne Shtetin e permendur ne fillim, ne qoftese:

a) perfituesi (marresi) eshte prezent ne Shtetin tjeter per nje periudhe ose periudha qe nuk i kalojne ne total 183 dite ne vitin perkates tatimor; dhe

b) shperblimi paguhet nga, ose ne emer te, nje punedhenesi qe nuk eshte rezident i Shtetit tjeter, dhe

c) shperblimi nuk ka lindur nga nje seli e perhershme ose baze fikse qe punedhenesi ka ne Shtetin tjeter.

3. Perjashtuar dispozitat e meparshme te ketij Neni, shperblimet e realizuara nga nje sipermarrje e nje Shteti Kontraktues lidhur me punen e ushtruar ne bordin e nje anije ose avioni qe veprojne ne trafikun nderkombetar, mund te tatonen ne ate Shtet.

Neni 17

Shperblimet e drejtoreve

Shperblimet e drejtoreve dhe pagesa te tjera te ngjashme te realizuara nga nje rezident i nje Shteti Kontraktues ne poziten e tij si anetar i Keshillit te drejtoreve te nje kompanie qe eshte rezidente e Shtetit tjeter Kontraktues, mund te tatonen ne kete Shtet tjeter.

Neni 18

Artistet dhe sportistet

1. Pavaresisht nga dispozitat e neneve 15 dhe 16, te ardhurat e realizuara nga nje rezident i nje Shteti Kontraktues si nje artist, aktor teatri, kinematografie, radio-televizioni,

muzikant apo sportist, nga aktiviteti i tij personal ne fushat e siperpermendura, i ushtruar ne Shtetin tjeter Kontraktues, mund te taten ne kete Shtet tjeter.

2. Kur te ardhurat lidhur me aktivitetet personale te ushtruara nga nje artist ose sportist ne poziten e tij si i tille realizon jo direkt nga sportisti apo artisti por nga nje person tjeter, keto te ardhura, perjashtuar dispozitat e neneve 7, 15 dhe 16, mund te taten ne Shtetin Kontraktues ne te cilin jane ushtruar aktivitetet e artistit apo sportistit.

3. Dispozitat e paragrafeve 1 dhe 2, nuk do te zbatohen ndaj te ardhurave te realizuara nga aktivitetet e ushtruara ne nje Shtet Kontraktues neqoftese aktivitetet jane ushtruar brenda kuadrit te nje vizite qe direkt ose indirekt eshte mbeshtetur teresisht ose kryesisht nga fonde publike te Shtetit tjeter Kontraktues, nje nendarje politike, nje autoritet lokal ose insitucion publik i ketij Shteti.

Neni 19

Pensionet dhe shperblime te tjera te ngjashme

1. Bazuar ne dispozitat e paragrafit 2 te Nenit 20, cdo pension dhe shperblime te tjera te ngjashme te krijuara ne nje Shtet Kontraktuese dhe paguar nje rezidenti te Shtetit tjeter Kontraktues lidhur me punesimin e tij ne te kaluaren do te taten vetem ne kete Shtet tjeter.

2. Termi "shperblime te tjera te ngjashme" perfshin edhe shumat periodike, vjetore apo ne periudha te tjera te caktuara, qofshin keto me para apo ne vlera te tjera pasurore.

Neni 20

Sherbimet qeveritare

1.a) Shperblimet e tjera vec pensioneve, te paguara nga nje Shtet Kontraktues, nje nendarje politike, nje autoritet lokal

ose nje institucion statuar i ketij Shteti ndaj cdo individi lidhur me sherbimet e kryera atij Shteti, nendarje politike, autoritet lokal apo institucion statuar, do te tatonen vetem ne ate Shtet.

b) Megjithate, keto shperblime mund te tatonen vetem ne Shtetin tjeter Kontraktues nese sherbimet jane kryer ne kete Shtet tjeter rezident i te cilit eshte individi perfitues, i cili:

(i) eshte nenshtetas i atij Shteti; ose

(ii) nuk eshte bere rezident i atij Shteti vetem per qellim te kryerjes se sherbimeve.

2. Cdo pension i paguar nga, ose prej fondeve te krijuara nga nje Shtet Kontraktues, nenndarje politike, autoritet lokal ose institucion statuar do te tatonen vetem ne ate Shtet.

3. Dispozitat e neneve 16, 17 dhe 19 do te zbatohen mbi shperblimet dhe pensionet lidhur me sherbimet e kryera ne lidhje me nje aktivitet biznesi te ushtruar nga nje Shtet Kontraktues, nendarje politike, autoritet lokal ose institucion statuar ne kete Shtet.

Neni 21

Studentet dhe specializimet

1. Nje individ qe eshte rezident i nje Shteti Kontraktues menjehere perpara vajtjes ne Shtetin tjeter Kontraktues dhe eshte prezent ne kete Shtet tjeter vetem :

(a) si nje student ne nje Universitet te njohur, kolegji, shkolle ose institucion tjeter arsimor te ngjashem ne kete Shtet tjeter;

(b) si nje specializant teknik ose biznesi;

(c) si perfitues i nje fondacioni, burse apo shperblimi kryesisht per qellim studimi, kerkimi apo trainingu nga Qeveria e cdonjerit Shtet ose nga nje organizate shkencore, arsimore, fetare apo bamiresie ose nen programe te asistences teknike te miratuara nga Qeveria e secilit Shtet,

do te perjashtohen nga tatimi ne kete Shtet tjeter mbi :

(i) te gjitha pagesat nga jashte per qellime te jetes, arsimimit, studimit ose specializimit;

(ii) shumat e te tilla dhurimeve, bursave apo shperblimeve; dhe,

(iii) cdo shperblim qe nuk kalon 2000 dollare amerikane ne vit lidhur me sherbimet te jene kryer ne lidhje me studimin, kerkimin ose specializimin, ose jane te domosdoshme per jetesen e tij atje.

Neni 22

Pedagoget dhe kerkuesit shkencore

1. Nje individ qe eshte rezident i nje Shteti Kontraktues menjehere para vajtjes ne Shtetin tjeter Kontraktues, dhe qe me ftese te nje Universiteti, kolegji ose institucioni arsimor, shkon ne kete Shtet tjeter per nje periudhe qe nuk i kalon dy vjet vetem me qellim mesimdhenie ose pune shkencore apo te dyja ne institucioni te tilla arsimore, do te perjashtohet nga tatimi ne ate Shtet tjeter per cdo shperblim lidhur me mesimdhenien ose kerkimin shkencor qe eshte subjekt i tatimit ne Shtetin Kontraktues te permendur ne fillim.

2. Ky nen nuk do te zbatohet ndaj te ardhurave nga kerkimet shkencore nese keto kerkime ndermerren kryesisht per perfitime private te nje personi apo personave te vecante.

Neni 23

Te ardhura te tjera

1. Lloje te te ardhurave te tjera te nje rezidenti te nje Shteti Kontraktues, qe nuk permenden shprehimisht ne Nenet e meparshme te kesaj Marreveshje do te tatonen vetem ne ate Shtet Kontraktues, pervec kur keto te ardhura rrjedhin nga burime ne Shtetin tjeter Kontraktues dhe mund te tatonen gjithashtu edhe ne ate Shtet tjeter.

Neni 24

Eliminimi i tatimit te dyfishte

1. Ne baze te ligjeve te Malaizise lidhur me kreditimin e tatimit Malaizian per tatimin e pagueshem ne cdo vend tjeter, tatimi shqiptar i pagueshem sipas ligjeve te Shqiperise dhe ne perputhje me keto Marreveshje nga nje rezident i Malaizise lidhur me te ardhurat e realizuara nga Shqiperia do te akreditohet perkundrejt tatimit Malaizes te pagueshem per keto te ardhura. Kur te tilla te ardhura jane dividente te paguara nga nje kompani qe eshte rezidente e Shqiperise, nje kompanie qe eshte rezidente e Malaizise dhe qe zoteron jo me pak se sa 15 per qind te aksioneve me te drejte votimi ne kompanine paguese te dividendeve, kreditimi do te marre ne konsiderate tatimin Shqiptar te pagueshem nga ajo kompani lidhur me te ardhurat e saj nga te cilat paguhen dividendet. Megjithate, kreditimi nuk do te kaloje ate pjese te tatimit Malaizes, te llogaritur para akreditimit, qe i takon ketyre zerave te te ardhurave.

2. Per qellimet e paragrafit 1 te ketij neni, termi "tatim i pagueshem shqiptar" do te perfshije cdo shume qe do te ishte e pagueshme si tatim shqiptar ne perputhje me keto Marreveshje, por nuk eshte i pagueshem per shkak te nje perjashtimi apo reduktimi tatimor te dhene per nje periudhe te caktuar kohe sipas ligjeve te Shqiperise per te nxitur zhvillimin ekonomik.

3. Kur nje rezident i Shqiperise realizon te ardhura te

cilat, ne perputhje me dispozitat e kesaj Marreveshje mund te taten ne Malaizi, Shqiperia do te lejoje si reduktim nga tatimi i saj mbi te ardhurat e atij rezidenti nje shume te barabarte me tatimin e pagueshem Malaizes. Megjithate, ky reduktim nuk do te kaloje ate pjese te tatimit Shqiptar te llogaritur para reduktimit, qe i atribuohet te ardhurave qe taten ne Malaizi.

4. Per qellimet e paragrafit 3, termi "tatim i pagueshem Malaizes" do te perfshije shumen e tatimit Malaizes qe do te ishte paguar nese tatimi Malaizes nuk do te ishte reduktuar ose eleminuar me perputhje me dispozitat e kesaj Marreveshje, dhe :

(a) nxisat e vecante tatimore sipas ligjeve Malaizese per stimulimin e zhvillimit ekonomik te Malaizise ose cdo dispozite tjeter qe mund te paraqitet ne Malaizi si modifikim apo shtese te ligjeve egzistuese, por qe do te bihet dakord nga autoritetet e Shteteve Kontraktuese per karakterin e tyre teper te ngjashem; dhe

(b) interesat ndaj te cilave zbatohet paragrafi 3 i nenit 11 dhe nuk jane perjashtuar nga tatimi malaizian ne baze te atij paragrafi.

Neni 25

Mos-diskriminimi

1. Nenshtetasit e nje Shteti Kontraktues nuk do te jene, ne Shtetin tjeter Kontraktues, subjekt i ndonje tatimi ose kerkese te lidhur me te qe te jete i ndryshem ose me i rende se sa tatimi ose kerkesat e lidhura me te, te cilave i nenshtrohen nenshtetasit e ketij Shteti tjeter ne rrethana te njejta.

2. Tatimi i nje selie te perhershme qe nje sipermarrje e nje Shteti Kontraktues ka ne Shtetin tjeter Kontraktues nuk do te jete me pak i favorshem ne kete Shtet tjeter se sa tatimi i ngarkuar ndaj sipermarrjeve te ketij Shteti tjeter qe ushtrojne aktivitete te njejta.

3. Siper marrjet e nje Shteti Kontraktues, kapitali i te cilave eshte totalisht ose pjeserisht i zoteruar apo kontrolluar, direkt ose indirekt, nga nje ose me shume rezidente te Shtetit tjetër Kontraktues, nuk do te jene ne Shtetin e permendur ne fillim subjekt i ndonje tatimi ose kerkese te lidhur me te, qe te jete i ndryshem ose me i rende se sa tatimi ose kerkesat e lidhura me ane te te cilave i nenshtrohen siper marrje te tjera te ngjashme te Shtetit te permendur ne fillim.

4. Dispozitat e ketij Neni nuk detyrojne :

(a) nje Shtet Kontraktues qe t'i siguroje individeve qe jane rezidente te Shtetit tjetër Kontraktues shperblime personale, lehtesime apo reduktime per qellime tatimore per gjendjen civile apo pergjegjesite familjare qe ai i siguron rezidenteve te tij ;

(b) Malaizine qe t'i siguroje nenshtetasve te Shqiperise qe nuk jane rezidente ne Malaizi, ato shperblime, lehtesime apo reduktime personale per qellime tatimore qe me ligj jane te vlefshme ne daten e nenshkrimit te kesaj Marreveshje vetem per nenshtetasit Malaiziane qe nuk jane rezidente ne Malaizi.

5. Dispozitat e ketij Neni nuk mund te merren si detyrim per secilin Shtet Kontraktues qe te kufizojne tek nenshtetasit e vet gezimin e lehtesive tatimore te dhena per nxitjen e zhvillimit ekonomik ne ate Shtet.

6. Ne kete Nen, termi "tatim" nenkupton tatimet ndaj te cilave zbatohet kjo Marreveshje.

Neni 26

Procedura e mirekuptimit reciprok

1. Kur nje person mendon se veprimet e njerit apo e te dy Shteteve Kontraktuese e rendojne apo do ta rendojne ate me tatime qe nuk jane ne perputhje me kete Marreveshje, pavaresisht nga menytrat e ankimit te parashikuara ne legjislacionin e brend-

shem te ketyre Shteteve, ai mund t'ia paraqese rastin e tij autoriteteve kompetente te Shtetit Kontraktues rezident i te cilit ai eshte, ose nese rasti lidhet me paragrafin 1 te nenit 25, ai mund t'ia paraqese rastin Shtetit Kontraktues nenshtetas i te cilit ai eshte. Ankesa duhet te paraqitet brenda tre vjeteve nga njoftimi i pare lidhur me tatimin qe nuk eshte ne perputhje me dispozitat e kesaj Marreveshje.

2. Autoriteti kompetent, nese kerkesa i duket e justifikuar dhe ai vete nuk e ka te mundur arritjen e nje zgjidhje te kenaqshme, do te perpiqet t'a zgjidhe ceshtjen me mirekuptim reciprok me autoritetin kompetent te Shtetit tjetër Kontraktues, me synim shmangien e tatimit qe nuk eshte ne perputhje me dispozitat e kesaj Marreveshje.

3. Autoritetet kompetente te Shteteve Kontraktues do te perpiqen qe me mirekuptim reciprok te zgjidhin cdo veshtiresi apo dyshim gjithashtu mund te konsultohen sebashku per eliminimin e tatimit te dyfishte edhe ne rastet kur kjo nuk sigurohet nga kjo Marreveshje.

4. Autoritetet kompetente te Shteteve Kontraktues mund te komunikojne me njeri tjetrin direkt per arritjen e mirekuptimit ne kuptimin e paragrafeve te mesiperme.

Neni 27

Shkembimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente te Shteteve Kontraktues do te shkembjne informacionet e nevojshme per zbatimin e dispozitave te kesaj Marreveshje ose per parandalimin apo eliminimin e evazionit apo shmangieve nga tatimet qe mbulon kjo Marreveshje. Cdo informacion i shkëmbyer ne kete menyre do te trajtohet si sekret, dhe do t'i serviret vetem personave apo autoriteteve (perfshire gjykatat dhe organet administrative) te perfshira ne llogaritjen apo bmladhjen e tatimeve, me imponimin ose ndjekjet lidhur me shkeljet tatimore apo lidhur me ankesat ndaj tatimeve qe mbulon marreveshja.

2. Ne asnje rast dispozitat e paragrafit 1 nuk do te interpretohen ne kuptimin qe i imponojne njerit prej Shteteve Kontraktues detyrimin:

a) te zbatoje masa administrative ne ndryshimin me ligjet dhe praktikat administrative te atij Shteti apo te Shtetit tjeter Kontraktues.

b) te jape informacione qe ndalohen sipas ligjeve apo praktikes normale administrative te atij Shteti apo te Shtetit tjeter Kontraktues;

c) te jape informacione qe mund te nxirrnin nje sekret tregtar, industrial apo profesional apo informacione, komunikimi i te cilave do te ishte ne kundërshtim me rendin publik.

Neni 28

Funksionaret diplomatike dhe konsullore

Dispozitat e kesaj Marreveshje nuk cenojne privilegjet fiskale te funksionareve diplomatike dhe konsullore qe rrjedhin nga rregullat e pergjithshme te se drejtes nderkombetare dhe nga dispozita te Marreveshjeve te vecanta.

Neni 29

Hyrja ne fuqi

1. Kjo Marreveshje do te ratifikohet nga te dy Shtetet Kontraktuese dhe instrumentat e ratifikimit do te shkembehen sa me shpejt qe te jete e mundur.

2. Kjo Marreveshje do te hyje ne fuqi me shkembimin e instrumentave te ratifikimit dhe do te kete efekt :

(a) ne Malaizi :

33

(i) lidhur me tatimet e vjelura ne burim, per te ardhurat e realizuara me ose pas dites se pare te janarit ne vitin kalendarik qe pason vitin ne te cilin kjo Marreveshje hyn ne fuqi;

(ii) lidhur me tatimet mbi te ardhurat, per tatimet e pagueshme per cdo vit te vleresimit qe fillon me ose pas dites se pare te Janarit te vitit te dyte kalendarik qe pason vitin ne te cilin kjo Marreveshje hyn ne fuqi dhe vitet e vleresimit qe pasojne.

(b) Ne Shqiperi lidhur me te ardhurat e realizuara me ose pas dites se pare te janarit te vitit kalendarik qe pason vitin ne te cilin Marreveshja hyn ne fuqi.

Neni 30

Perfundimi

Kjo Marreveshje do te mbetet ne fuqi pa kufij kohore, por secili Shtet Kontraktues mund ta perfundoje Marreveshjen, nepermjet kanaleve diplomatike, duke i dhene Shtetit tjetar Kontraktues njoftimin me shkrim te perfundimit me ose perpara 30 qershorit ne cdo vit kalendarik pas periudhes prej pese vitesh nga data ne te cilin kjo Marreveshje hyn ne fuqi. Ne nje rast te tille Marreveshja do te konsiderohet se ka fuqi :

(a) Ne Malaizi :

(i) lidhur me tatimet e vjelura ne burim per te ardhurat e realizuara me ose pas dites se pare te Janarit ne vitin kalendarik qe pason vitin ne te cilin eshte dhene njoftimi;

(ii) lidhur me tatime te tjera mbi te ardhurat, tatime te pagueshme per cdo vit te vleresimit qe fillon me ose pas dites se pare te Janarit te vitit te dyte kalendarik qe pason vitin ne te cilin eshte dhene njoftimi.

24

(b) Ne Shqiperi, lidhur me te ardhurat e realizuara me ose pas dites se pare te janarit te vitit kalendarik qe pason vitin ne te cilin eshte dhene njoftimi i perfundimit.

Bere ne dublikate ne Kuala Lumpur me 24 janar 1994, ne gjuhen Shqipe, Malaiziane dhe ne gjuhen Angleze; te trija tekstet kane vlera te barabarta. Ne rast konfliktesh ne interpretimin dhe aplikimin e kesaj Marreveshje, teksti ne gjuhen Angleze do te privqhet.

PER QEVERINE E

REPUBLIKES SE SHQIPERISE

PER QEVERINE E

MALAIZISE